

DOKUMENTI I SHKURTËR PËR POLITIKA PUBLIKE NR.12/2021

ARSIMI SI FAKTOR I LUFTËS SË QËNDRUESHME KUNDËR KORRUPSIONIT

MARTINA ILIEVSKA



Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit "Edukimi anti-korrupsion për nxënësit e shkollave të mesme" me ndihmë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, zbatuar nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup së bashku me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Impresum

Titull: Arsimi si faktor i luftës së qëndrueshme kundër korrupsionit

Autor: Martina Ilievska

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Përkthimi: Vjosa Taipi

Dizajni: Matea Iondza Shumkovska

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.idscs.org.mk>

Përmbledhje:

Arsimi është pjesë e domosdoshme e luftës kundër korrupsionit. Është pjesë e procesit afatgjatë të socializimit dhe vend ku shteti mund të investojë në krijimin afatgjatë të gjeneratave që do të luftojnë korrupsionin. Në atë mënyrë, vendi do të përfshihet në prodhimin e qëndrueshmërisë, si mbështetje për reformat ekzistuese të sektorit anti-korrupsion.

Rekomandime:

Qëllimet e edukimit kundër korrupsionit duhet të bëhen më ambicioze. Nga njësi mësimore sot, ajo duhet të bëhet një nga qëllimet kryesore të procesit arsimor, që do të ndërtojë breza me integritet personal, të gatshëm të luftojnë korrupsionin. Bashkëpunimi ndërinstitucional, në planifikimin e qëllimeve dhe përmbajtjeve, dhe krijimi i tyre duhet të vazhdojë dhe të bazohet në atë që është bërë deri më tani.

Lufta kundër korrupsionit është proces i gjatë që kërkon përfshirjen e shumë aktorëve në shoqëri. Miratimi i Ligjit për luftë kundër korrupsionit nuk e zgjidh problemin, nevojitet një strategji sistemike dhe zbatim efektiv i ligjeve. Korrupsioni si praktikë e zakonshme në Ballkan shpesh lidhet me të kaluarën historike të rajonit të Ballkanit.¹ Sipas Mungiu-Pipidi "në shoqëritë ku modernizimi nuk është i plotë dhe shteti ka qenë gjithmonë në pronësi "private" të grupeve të caktuara të privileguara, qasja është e gabuar sepse sugjeron fazë krejtësisht tjetër të evolucionit. Kërkimi i zgjidhjeve në legjislacionin anti-korrupsion të demokracive të zhvilluara perëndimore është gjithashtu i papërshtatshëm: përgjigjet se si të ndërtojme një shtet të drejtë dhe burokratik, mund të gjenden në historinë e këtyre vendeve, jo në sistemin e tyre aktual ligjor."² Autori thekson se shumë për shumë nga sjelljet në Evropën Juglindore zakonisht fajësohen "trashëgimive historike", siç janë faktorët kulturorë para-komunistë, trashëgimitë autoritare dhe shkatërrimi i shtetit pas komunizmit.

Pothuajse tridhjetë vjet pas pavarësisë, vendi është ende në tranzicion dhe është ndërtuar mbi idenë e demokracisë dhe një sërë vlerash demokratike. Tranzicioni demokratik është proces i vështirë, i suksesshëm në disa fusha, por shumë më pak në fushën e transformimit shoqëror.

Mungesa e efikasitetit në trajtimin e korrupsionit tregohet edhe nga rënia e vendit për 5 vendenë renditjen e vendeve në Indeksin e perceptimit të korrupsionit të Transparency International për vitin 2020.³ Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për ngecjen e vendit në luftën kundër korrupsionit treguar nga

Indeksi në një deklaratë theksoi se "për luftë efektive, përveç standardizimit dhe deklarimit, nevojiten burime adekuate të institucioneve kompetente dhe organeve mbikëqyrëse dhe më e rëndësishmja, angazhim dhe monitorim të rasteve të korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Ndikimi i politikës, keqpërdorimi i detyrës dhe autoritetit, nepotizmi, klientelizmi dhe kronizmi janë ende gjerësisht të përhapura". Pas formimit të Qeverisë në vitin 2020, një nga prioritetet strategjike ishte "Sundimi i ligjit, pavarësia e gjyqësorit, lufta konsekuente dhe jo selektive kundër krimit dhe korrupsionit me transparencë të gjerë dhe obliguese", dhe për herë të parë u emërua zëvendës kryetar i qeverisë për Luftë Kundër Korrupsionit dhe Krimin, Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Burimeve Njerëzore, detyra e të cilit është të punojnë për të çrënjësuar korrupsionin në vend.

Ndërhyrjet institucionale janë të destinuara të dështojnë nëse nuk krijohet mjedisi i nevojshëm shoqëror në të cilin edhe një grup i vogël njerëzish me integritet në institucionet anti-korrupsion mund të gjejë grup të madh aleatësh. Flasin për kushtet shoqërore në të cilat qytetarët do të sigurojnë mbrojtje në rastet kur institucionet anti-korrupsion do të sulmohen nga aktorë të fuqishëm të korruptuar nga sfera politike dhe sektori privat. Është inkurajuese që sondazhet e opinionit publik tregojnë se numri i qytetarëve që nuk e aprovojnë korrupsionin po rritet. Raporti për Vlerësimin e Korrupsionit: niveli i korrupsionit i Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) tregon se 59% e qytetarëve nuk i aprovojnë praktikat korruptive, krahasuar me vitin 2018 kur qytetarët ishin të ndarë në pikëpamjet e tyre për korrupsionin (50%).⁴

¹ Reçica, Vlora, (2018). "Everybody Does It: Youth Acceptance and Ignorance of Corruption ".достапно на : [ISIE-Proceedings-Corruption-Higher-Education-and-Whistleblowers.pdf](#) . (стр. 117-132).

² Mungiu-Pipidi, Alina. 2005. "Deconstructing Balkan Particularism: The Ambiguous Social Capital of Southeastern Europe." Southeast European and Black Sea Studies 5.

³ Transparency international. Indeksi i perceptimit të korrupsionit. Në dispozicion në <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/mkd>

⁴ Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2020. "Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit: niveli i korrupsionit" Në dispozicion në: <https://mcms.mk/images/docs/2020/izveshtaj-za-procena-na-korupcijata-vo-severna-makedonija-2020.pdf>

Por nga ana tjetër, shqetëson shkalla në të cilën korrupsioni është i pranueshëm për të rinjtë e vendit. Kjo situatë ka qenë e qëndrueshme për dy studime të njëpasnjëshme dhe toleranca ndaj korrupsionit është më e lartë tek të rinjtë e moshës 18 deri 29 vjeç, sesa te grup-moshat e tjera. Dy të tretat e tyre do të jepnin para për të zgjidhur një problem nëse nuk ka asnjë mënyrë tjetër, që përbën rreth 25 pikë të përqindjes më shumë sesa, për shembull, të anketuarit të moshës mbi 60 vjeç.⁵

Toleranca ndaj korrupsionit dhe pranimi i praktikave korruptive midis popullatës së re thekson nevojën për vlerë anti-korrupsion përmes krijimit të klimës anti-korrupsion në shkolla.

Gjatë kësaj periudhe, Qeveria e re gjithashtu prezantoi reformat në procesin arsimor si fushë me prioritet të lartë dhe filloi përmes rishikimit të mjeteve mësimore për nxënësit, deri në një koncept krejtësisht të ri për arsimin fillor. Arsimi ka ndikim të madh në ndërtimin e personalitetit. Është fakt se sistemi arsimor në Maqedoni është i vjetërsuar dhe me shumë mangësi që dolën në sipërfaqe me pandeminë dhe rregullimet e nevojshme në procesin arsimor në të gjitha nivelet. Reformat themelore që do të rezultojnë me arsimin modern janë më se të nevojshme.

Angazhimi për reforma në procesin arsimor mund të përdoret që të vazhdojnë reformat tashmë të filluara në fushën e edukimit anti-korrupsion. Si temë, ajo tashmë është vendosur në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm profesional. Për sa i përket programit mësimor, mbetet të vendoset në arsimin e mesëm, gjimnaz. Mirëpo, pasi rruga e reformave në arsim është më ambicioze, fokusi duhet të përqendrohet në

arsimin që vlerëson mendimin kritik dhe arsyetimin dhe vendosjen e vlerave bazuar në postulatet e qeverisjes së mirë, në mënyrë që të ndërtojë integritet personal tek të rinjtë. Me fjalë të tjera, integriteti personal, i cili do t'u mundësojë qytetarëve të bëjnë aleatë në luftën kundër korrupsionit, duhet të jetë themeli i procesit arsimor.

Promovimi i integritetit midis të rinjve është mënyrë për të lëvizur shoqërinë lart dhe është thelbësore për ndërtimin e një të ardhme më të mirë. Arsimi mund të jetë thelbësor për parandalimin e korrupsionit dhe ndërtimin e vlerave tek të rinjtë. Pjesa më e madhe e informacionit të rinjtë i marrin përmes rrjeteve sociale dhe mediave, të cilat japin një ide të paqartë për tema komplekse siç është korrupsioni. Arsimi anti-korrupsion i integruar në aktivitetet shkollore paraqet mundësi të rinjtë të marrin të dhëna të strukturuar dhe objektive. Qëllimi nuk është thjesht t'i mësojmë ata që rryshfeti është i gabuar, por t'u prezantojmë atyre çështje etike shumë më komplekse në lidhje me konfliktin midis interesave personale dhe familjare nga njëra anë dhe interesit publik të komunitetit nga ana tjetër.

Nevoja për ndryshime në arsim dhe përfshirja e arsimit anti-korrupsion si mjet për ndërtimin e personalitetit janë të dukshme, pas së cilës lindin pyetje: Cila është forma e përshtatshme e përfshirjes në aktivitetet e shkollës?; Cila është qasja për të bërë ndryshim të tillë? Dhe cili është kufiri i duhur i moshës kur duhet filluar edukimi i tillë?

Suksesi afatgjatë i Maqedonisë së Veriut varet nga ajo se sa mirë i përgatisim gjeneratat e ardhshme për të kundërshtuar dhe të aktivizohen kundër korrupsionit.

⁵ Ibid

Arsimi anti-korrupsion në shkollë mund të përfshihet në të paktën dy forma. Së pari, në hartimin e programit të ri për arsimin fillor dhe të mesëm, fokusi duhet të përqendrohet në centralizimin e temës si një qëllim arsimor dhe ngritjen e rangut të vlerave themelore të procesit. Kjo ndryshon cilësisht nga vendosja e temës si edhe një njësi tjetër në procesin e mësimor në lëndët përkatëse, siç janë edukimi qytetar, etika dhe sociologjia. Ideja e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për ndërthurjen e temave në disa lëndë në të njëjtën periudhë, mund të ndihmojë mbi kuptimin shumë-anësh të problemit të korrupsionit dhe ndërtimi gradual i një personi rezistent ndaj korrupsionit. Nga pjesa formale, edukimi anti-korrupsion duhet të transferohet në aktivitete jo obligative dhe në punën në projekte në mënyrë që të stimulojë integrimin e asaj që është mësuar dhe të inkurajojë nxënësit të punojnë së bashku.

Qasja e tillë kërkon përfshirjen e disa palëve të interesuara në proces dhe nuk duhet t'i lihet vetëm Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Paraqet mundësi për bashkëpunim ndërinstitucional dhe veprim të përbashkët për shoqëri që është më pak tolerante ndaj korrupsionit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (si përgjegjëse për arsimin fillor dhe të mesëm) duhet të ketë rol koordinues në ndryshimet, por qasja ndërinstitucionale duhet të përfshijë ekspertë të fushës, siç është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe ekspertë nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit që do të punojë në ndryshimin e planeve mësimore

dhe zgjerimin e përmbajtjeve mësimore me të përshtatshme.

Ajo që është bërë deri më tani si materiale të nevojshme për programe mësimore është produkt i bashkëpunimit ndërinstitucional. Kështu, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe BZHA, në projekt të Institutit për Demokraci "Societas Civilis" dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, përgatitën program dhe mjete ndihmëse për mësimin e temës së korrupsionit në arsimin e mesëm. Në të kaluarën, themelet për anti-korrupsionin në arsimin fillor u hodhën përsëri nga bashkëpunimi midis këtyre institucioneve shtetërore dhe Qendrës për Edukimin Qytetar. Gjatë kësaj periudhe, BZHA dhe Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar ndihmuan në përgatitjen e programeve dhe mjeteve për arsimin fillor dhe arsim të mesëm profesional.

Mirëpo, tani është koha që ambicia të rritet dhe lufta kundër korrupsionit të zërë një vend më të spikatur në arsim. Mësuesit nuk duhet të lihen mënjanë gjatë procesit dhe në të njëjtën kohë duhet të punohet me ta në rritjen e njohurive të tyre në lidhje me temën e korrupsionit, format dhe mjetet anti-korrupsion, me qëllim të jenë në gjendje të transferojnë siç duhet njohuritë e tyre tek nxënësit. Në dialog me ta, shihet se është e nevojshme të punohet rrënjësisht për të hequr të gjitha dilemat etike, kur shkohet më thellë në kompleksitetin e fenomenit të korrupsionit.⁶ Përfshirja e edukimit anti-korrupsion në programet mësimore ekzistuese është proces me një kahe i cili është më afatgjatë përkundër arsimit joformal dhe

⁶ Projekt "Edukim Antikorrupsion në Arsimin e Mesëm" përfshin trajnimin e mësuesve në pilot shkolla.

aktivitetet jashtëshkollore, sepse përfshin mësuesit si një lidhje kyçe në procesin edukativ - arsimor.

Njohja e vlerave demokratike duhet të përshtaten siç duhet për moshën e fëmijëve dhe t'i fitojnë që në moshë më të hershme, prandaj tema të tilla përfshihen në arsimin fillor. Për më tepër, në arsimin e mesëm, procesi duhet të vazhdojë për të përgatitur nxënësit për detyrën e tyre të ardhshme qytetare dhe të identifikojnë dhe kundërshtojnë korrupsionin

Përfshirja e të rinjve në luftën kundër korrupsionit përmes vendosjes së vlerave dhe promovimin

e integritetit është mënyrë për lëvizjen e shoqërisë e cila do të bëhet më pak tolerante ndaj praktikave korruptive. Arsimi është faktori kryesor në arritjen e këtij qëllimi, përmes edukimit përkatës, zgjerimit të programeve mësimore dhe ofrimit të programeve të përshtatshme. Lufta kundër korrupsionit është proces i gjatë, me investim të madh që do ta mbështesë atë. Një pjesë e këtij investimi duhet të realizohet në arsim si fazë e socializimit që do të përgatisë brezat e ardhshëm të jenë aleatë dhe pandan në luftën institucionale kundër korrupsionit.

Informacione rreth IDSCS-ë

IDSCS është tink tenk organizatë, që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integrimet evropiane të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën politike participative. Përmes forcimit të vlerat liberaliste, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve

Të dhëna për kontakt, për IDSCS

**Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 / 2,
1000 Shkup**
Tel. Nr.: +389 2 3094 760,
e-mail: contact@idscs.org.mk

Informacion mbi KSHPK

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) është i pavarur në kryerjen e veprimtarive të përcaktuara me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe ka statusin e personit juridik. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit zbaton dhe fillon zbatimin e ligjeve, inkurajon forcimin normativ dhe institucional, krijon politika dhe masa anti-korrupsion, ndërmerr aktivitete që synojnë forcimin e integritetit personal dhe institucional, përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe zhvillon një kulturë ligjore, dhe misioni i tij është të krijojë sistem efektiv për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Informacione për kontakt për KSHPK:

**Rr. Dame Gruev 1,
1000 Shkup,**
tel. : +389 2 3215 377,
email contact@dksk.org.mk,
ueb faqja www.dksk.mk

Informacione rreth projektit

Projekti "Edukimi Antikorrupsion në Shkollat e Mesme" synon të rrisë ndërgjegjësimin tek të rinjtë për korrupsionin, të forcojë njohuritë e tyre për korrupsionin, format e korrupsionit dhe mjetet anti-korrupsion, si dhe të forcojë njohuritë e tyre për rëndësinë e ndërtimit të integritetit personal.

Projekti zbatohet nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup, së bashku me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me mbështetje financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës. Aktivitetet e projektit mbështeten nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

